



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Kuvendi

P R O J E K T L I G J

Nr. _____ /2019

PËR
DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË LIGJIN NR.9975, DATË 28.7.2008, “PËR
TAKSAT KOMBËTARE”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 155, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë

V E N D O S I:

Në ligjin nr.9975, datë 28.7.2008, “Për taksat kombëtare”, të ndryshuar bëhen ndryshimet dhe shtesat, si më poshtë vijon:

Neni 1

Në nenin 4 “Niveli i taksave kombëtare” bëhet këto ndryshime:

1. Në pikën 8 pas fjalisë së parë shtohet fjalia:

“Në rastet kur në artikujt që importohen në kapitullin 39 të NKM-së, pjesa joplastike zë më shumë se 51 për qind të masës së përgjithshme, kjo taksë zbatohet vetëm për pjesën e masës së plastikës.”

2. Në pikën 8/1, fjalët “25 lekë/kg” zëvendësohen me fjalët “10 lekë/kg”

3. Pika 8.5 riformulohet:

“8.5 Për ambalazhet plastike/qelqi, lëndët e para, si dhe për materialet/artikujt prej plastike, të cilat eksportohen dhe për të cilat taksa është paguar në momentin e importit/prodhimit të tyre, administrata doganore rimbursen shumën e taksës së

paguar. Rimbursimi bëhet sipas procedurave të përcaktuara në udhëzimin e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë.”

Neni 2

Ne nenin 9 “Përjashtime nga pagimi i taksave kombëtare”, në pikën 4, pas shkronjës “d” shtohen:

“dh) lëndët e para në forma primare, apo artikujt e tjerë të importuar dhe që klasifikohen në kapitullin 39 të NMK-së, të cilat përdoren si plotësues teknologjik, lëndë të para additive (agregate lidhës), apo si material për prodhimin e produkteve që nuk kategorizohen si artikuj plastike. Taksa për lëndët e para në forma primare apo artikujt e tjere të importuar, do të aplikohet vetëm nëse materialet/artikujt e prodhuara nga këto lëndë të para, janë subjekt i llogaritjes së taksës në rast se këto materiale/artikuj do të importohen.

“e) lëndët e para në forma primare për prodhimin e polisterolit (EPS expanded polysterene) si dhe importimi i paneleve, pllakave të polistirenit (XPS extruder polystyrene) sipas kapitullit 39 të NKM-së, artikuj të cilët përdoren në industrinë e ndërtimit në funksion të efijencës së energjisë.”

“ë) lëndët e para në forma primare për prodhimin e sfungjerëve si dhe importimi i materialeve/artikujve sipas kapitullit 39 të NKM-së, që përdoren në industrinë e prodhimit të mobiljeve.

“f) lëndët e para në forma primare me përmbajtje proteinike të forta, apo materiale celuzoike, sipas kapitullit 39 të NKM-së të cilat përdoren në industrinë e prodhimit të sallameve.

Kodet e detajuara të artikujve në kapitullin 39 që përjashtohen nga taksa sipas pikave “dh”, “e”, “ë” dhe “f” më sipër, përcaktohen në udhëzimin e Ministrit të Financave.

Neni 3

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

K R Y E T A R I

Gramoz RUÇI